



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 70

Tiranë – E mërkurë, 15 maj 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 50/2019 datë 8.5.2019	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 85/2017, “Për zgjedhjen e Byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit”, të ndryshuar..... 5283
Vendim i Kuvendit nr. 51/2019 datë 8.5.2019	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 86/2017, “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 5283
Vendim i Kuvendit nr. 52/2019 datë 8.5.2019	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 5283
Vendim i Kuvendit nr. 53/2019 datë 8.5.2019	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 14/2018, “Për ngritjen e nënkomisionit “Për administratën publike”, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut” 5284
Vendim i Kuvendit nr. 54/2019 datë 8.5.2019	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 99/2017 “Për ngritjen e nënkomisionit “Për qeverisjen vendore”, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut” 5284
Vendim i Kuvendit nr. 55/2019 datë 8.5.2019	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 87/2018 “Për ngritjen e nënkomisionit parlamentar “Për ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat””, në përbërje të Komisionit të përhershëm të Kuvendit për Sigurinë Kombëtare”..... 5285
Rezolutë e Kuvendit datë 8.5.2019	Për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2018..... 5285

Rezolutë e Kuvendit datë 8.5.2019	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2018.....	5286
Rezolutë e Kuvendit datë 8.5.2019	Për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2018.....	5288
Udhëzim i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 1, datë 6.5.2019	Për përcaktimin e mënyrës së ndarjes së kuotave vjetore të importit të substancave të kontrolluara.....	5289
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 185, datë 30.4.2019	Për delegim kompetence.....	5294
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 13, datë 6.3.2019	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Delvinë sh.a.....	5295
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 18, datë 19.4.2019	Për miratimin e rregullores “Procedura e ankimit në Komisionin Kombëtar Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, për një të licencuar”.....	5300
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 19, datë 19.4.2019	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 6, datë 3.2.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Gjyrokastër”, i ndryshuar.....	5307
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 20, datë 19.4.2019	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për miratimin e tarifave të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Malësi e Madhe.....	5308
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 21, datë 19.4.2019	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 44, datë 14.10.2016 “Për licencimin për herë të parë për sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Vorë”	5309
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Haxhi Tata.....	5309

**VENDIM
Nr. 50/2019****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 85/2017, “PËR
ZGJEDHJEN E BYROSË DHE
PËRBËRJEN E SEKRETARIATEVE TË
KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 10 e 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pas këshillimit me Kryetaren e Grupit Parlamentar Demokrat,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 85/2017, “Për zgjedhjen e Byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit”, të ndryshuar, në pikat I dhe II bëhen këto ndryshime:

1. Deputeti Myslim Murrizi zgjidhet Zëvendëskryetar i Kuvendit.

2. Deputeti Alban Zeneli zgjidhet Sekretar për Buxhetin.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 8.5.2019.

**VENDIM
Nr. 51/2019****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 86/2017,
“PËR CAKTIMIN E KRYESIVE TË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Grupit Parlamentar Demokrat dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar të Pavarur,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Në pikën I të vendimit të Kuvendit nr. 86/2017, “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Deputetja Rudina Hajdari caktohet Kryetare në Komisionin për Integrimin Evropian.

2. Deputetja Fatjona Dhimitri caktohet Kryetare në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

3. Deputeti Enver Roshi caktohet Kryetar në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

4. Deputeti Alban Zeneli caktohet Zëvendëskryetar në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.

5. Deputeti Halil Jakimi caktohet Zëvendëskryetar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

6. Deputeti Korab Lita caktohet Zëvendëskryetar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

7. Deputeti Ralf Gjoni caktohet Zëvendëskryetar në Komisionin për Politikën e Jashtme.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 8.5.2019.

**VENDIM
Nr. 52/2019****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 90/2017,
“PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 2, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017, “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Deputeti Andi Përmeti caktohet anëtar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

2. Deputeti Nikolin Staka caktohet anëtar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

3. Deputeti Zef Shtjefni caktohet anëtar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 8.5.2019.

VENDIM
Nr. 53/2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 14/2018, “PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT “PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE”, NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT”

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 14/2018, “Për ngritjen e nënkomisionit “Për administratën publike”, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”, bëhet ky ndryshim:

1. Deputetja Elena Xhina caktohet anëtare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 8.5.2019.

VENDIM
Nr. 54/2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 99/2017 “PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT “PËR QEVERISJEN VENDORE”, NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT”

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 99/2017 “Për ngritjen e nënkomisionit “Për qeverisjen vendore”, në përbërje të Komisionit të përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut” bëhen këto ndryshime:

1. Deputeti Korab Lita caktohet zëvendëskryetar.

2. Deputeti Halil Jakimi caktohet anëtar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 8.5.2019.

**VENDIM
Nr. 55/2019****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 87/2018 “PËR
NGRITJEN E NËNKOMISIONIT
PARLAMENTAR “PËR NDJEKJEN E
ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 12/2018 “PËR
VLERËSIMIN KALIMTAR DHE
PERIODIK TË PUNONJËSVE TË
POLICISË SË SHETIT, GARDËS SË
REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR
ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE
ANKESAT”, NË PËRBËRJE TË
KOMISIONIT TË PËRHERSHËM TË
KUVENDIT PËR SIGURINË
KOMBËTARE”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 87/2018 “Për ngritjen e nënkomisionit parlamentar “Për ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, në përbërje të Komisionit të përhershëm të Kuvendit për Sigurinë Kombëtare” bëhen këto ndryshime:

1. Deputeti Myslim Murrizi caktohet zëvendëskryetar.

2. Deputetët Alban Zeneli dhe Ylli Shehu caktohen anëtarë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 8.5.2019.

**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AGJENCISË SË SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2018**

Kuvendi i Shqipërisë, duke vlerësuar rolin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në shërbim të:

- Sigurimit të gatishmërisë operationale dhe vigjilencës ndaj çdo situatë që mund të ketë ndikim në stabilitetin financiar në vend;

- Ruajtjes së stabilitetit financiar dhe shmangies së krizave të mundshme financiare, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit përfundimtar të shërbimeve bankare, nëpërmjet ndërtimit të urave të komunikimit ndërmjet autoriteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse të sistemit bankar shqiptar;

- Rolit të ri që iu caktua me ligjin nr. 133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë” si administratore e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme;

Konstaton se gjatë vitit 2018 Agjencia:

- Ka vijuar të mbetet e angazhuar në drejtim të përmbushjes me eficiencë të mandatit të saj ligjor, e udhëhequr edhe nga rekomandimet e lëna nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për këtë vit.

- Ka vijuar bashkëpunimin ndërinstitutional, si anëtar i Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, dhe ka qenë në kontakt dhe konsultim të vazhdueshëm me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave, si partnerët strategjikë parësorë të Agjencisë në drejtim të objektivit të përbashkët të stabilitetit financiar.

- Ka konsideruar dhe ka marrë masa për respektimin dhe vënien në zbatim për vitin 2018 edhe të rekomandimeve të Kuvendit.

**Kuvendi i Shqipërisë i rekomandon
Agjencisë së Sigurimit të Depozitave që gjatë
vitit 2019:**

- Në zbatim të përcaktimeve ligjore dhe duke marrë në konsideratë kushtet ekonomike dhe sociale të Republikës së Shqipërisë, si dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të sigurimit të depozitave, të shqyrtojë dhe të vlerësojë përshtatshmërinë e treguesve të skemës së sigurimit të depozitave, duke përfshirë, ndër të tjera, normën e primit të sigurimit, nivelin e mbulimit për depozitat e siguruar, kategoritë e depozitave të sigurueshme dhe



atyre të përjashtuara nga sigurimi, si dhe raportin e synuar të mjaftueshmërisë së fondeve që Agjencia administron.

- Të vijojë testimin e sistemit, për sa i takon gatishmërisë në rast ngjarjeje sigurimi, infrastrukturën IT, komunikimin me depozituesit, ashtu si dhe bankën në likuidim dhe bankën agjente të përzgjedhur nga Agjencia për kryerjen e një procesi kompensimi, duke kryer simulime teknike dhe tematike, si dhe duke u angazhuar në simulimet ndërinstitucionale apo simulime për raste të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, me qëllim testimin e procedurave operacionale të hartuara në letër.

- Të thellojë më tej bashkëpunimin me Grupin Këshillimor të Stabilitetit Financiar dhe në veçanti me Bankën e Shqipërisë, duke marrë në konsideratë rolin kyç të këtij institucioni, si autoriteti përgjegjës rregullator dhe mbikëqyrës i sektorit bankar dhe financiar, si dhe misionin e përbashkët të dy institucioneve në drejtëm të zhvillimit të një sistemi financiar të shëndetshëm në shërbim të publikut dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë.

Miratuar në datën 8.5.2019.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

REZOLUTË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT PËR VITIN 2018

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke vlerësuar rolin e Autoritetit në drejtëm të përmbushjes së misionit të vet parësor për t'i siguruar akses në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit e më pas të informojë në lidhje me to subjektet që ngarkon ligji, si dhe të ruajë të dhënat e dokumenteve në arkiv, në mënyrë që të edukojë publikun dhe të mbështesë vlerat demokratike të drejtësisë, të së vërtetës, për gjeneratat e ardhshme;

- Duke njohur bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit me autoritetet e tjera publike, si dhe institucionet homologe ndërkombëtare;

- Duke marrë në konsideratë thirrjet e Parlamentit Evropian dhe rezolutave të Kuvendit, qoftë të rezolutës për dënimin e

krimeve të komunizmit, qoftë asaj për dënimin ndaj klerit, për të mbajtur gjallë kujtimin e së shkuarës;

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit për vitin 2018 në drejtëm të:

- Administrimit, në krahasim me një vit më parë, të një numri në rritje të kërkesave nga individë, institucione kushtetuese dhe autoritete të tjera publike, për kandidatë për t'u emëruar apo ngritur në detyrë, kërkesave nga subjekte politike për kandidatë për deputetë, kërkesave studimore, si dhe kërkesave për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi.

- Krijimit të një platforme të besueshme për akses në trashëgiminë e madhe të dokumenteve të ish-Sigurimit, me qëllim informimin e qytetarëve shqiptarë, duke u ofruar të dhëna, informacione dhe kontekst mbi arkivat e ish-Sigurimit.

- Plotësimit të kuadrit rregullator të brendshëm, me qëllim mirëfunksionimin dhe mbarëvajtjen e punës së institucionit, nëpërmjet miratimit gjatë vitit 2018 të “Kodit të sjelljes për anëtarët e AIDSSH-së”, “Kodit të sjelljes së mirë administrative”, si dhe të vendimit “Për standardizimin e komunikimit me subjektet e interesuara që kërkojnë informacion mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit pranë AIDSSH-së”.

- Forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar me struktura homologe të mbledhjes, ruajtjes, përpunimit, informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, ku përmenden bashkëpunimi me institucionin homolog çek dhe shkëmbimi i përvojave me YAD Vashem të Izraelit, si dhe sigurimi i mbështetjes dhe asistencës së ekspertëve të huaj të fushës, si PNUD dhe Qeveria e Italisë për programin “Përkujtojmë për të shëruar dhe parandaluar”, apo Qeveria e Zvicrës për projektin “Roli i shkencës në zhvillimin e shoqërisë gjatë viteve të para të vendosjes së regjimit komunist 1945-1954”.

- Rritjes së perceptimit të publikut për punën e institucionit pranë dhe në kontakt me qytetarin, si dhe për një institucion të hapur dhe transparent, i cili ofron informacionin e nevojshëm, sipas ligjit nr. 45/2015, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve ku janë publikuar dosje dhe dokumente të personaliteteve, të ngjarjeve të caktuara historike përkujtimore, duke



i trajtuar ato në bazë të kërkimeve shkencore dhe rikrijimin e kuadrit historik.

- Zhvillimit dhe forcimit të kapaciteteve administrative dhe të ekspertizës në fusha të ndryshme, veçanërisht ato që lidhen me informimin e individëve, institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike, të medias, studiuesve dhe garantimin e transparencës në procesin e informimit, ku veçanërisht është bashkëpunuar me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri në ndërtimin e një arkivi modern, në përputhje me standardet ndërkombëtare, për ngritjen dhe përgatitjen profesionale të stafit të AIDSSH-së, duke mundësuar shkëmbimin e përvojës me institucionet homologe në Gjermani dhe Çeki.

- Konsolidimit të bashkëpunimit me universitetet, arkivat dhe qendrat kërkimore, brenda dhe jashtë vendit, që punojnë në këto fusha për realizimin e fushatave ndërgjegjësuere për të shkuarën, siç ishte dhe fushata “Edhe muret kanë veshë” apo takimet e hapura në universitetet e Tiranës, Shkodrës, Durrësit, Korçës, Gjirokastrës, për temat e së kaluarës dhe informim mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit.

- Realizimit të veprimtarive informuese në terren për ta prezantuar Autoritetin si një platformë për angazhimin publik dhe kuptimin e së kaluarës komuniste në Shqipëri.

- Zhvillimit të një plani përhapjeje mediatike me materiale, duke përfshirë broshurat, mesazhet dhe imazhet dhe zhvillimi i Planit të Medias Sociale, duke përfshirë planet për aplikacionet Facebook, Instagram, LinkedIn, Twitter.

Kuvendi kërkon që Autoriteti dhe institucionet e tjera ligjzbatuese, për vitin 2019, të përmirësojnë punën në drejtim të:

- Përmirësimit të procesit të verifikimit të të dhënave, me qëllim nxjerrjen e vendimeve që përmbajnë të dhëna të sakta dhe precize, të cilat të mos jetë e nevojshme të korrigjohen.

- Përfundimit, brenda vitit 2019, të procesit të marrjes në dorëzim dhe inventarizimit të të gjitha dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit që gjenden në institucione të tjera të rrjetit arkivor.

- Përgatitjes së infrastrukturës logjistike të nevojshme për përfundimin, brenda vitit 2019, të procesit të transferimit nga arkivat e institucioneve të ndryshme, të të gjithë dokumentacionit që është marrë në dorëzim nga

Autoriteti, si dhe angazhimin maksimal të të gjitha palëve të përfshira në proces për ndërmarrjen e hapave për parandalimin e dëmtimit të mëtejshëm dhe ruajtjen e materialit arkivor ekzistues.

- Rritjes së bashkëpunimit me institucionet qeveritare për përfundimin sa më parë të procesit të identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe marrjen e masave të menjëhershme për të ruajtur dhe mbrojtur në mënyrë adekuate vendet që janë aktualisht të identifikuar si varreza masive.

- Publikimit të vendimeve dhe materialeve të miratuara nga Autoriteti, në funksion të transparencës dhe informimit për procesin vendimmarrës, duke respektuar kufizimet e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale.

- Përfundimit sa më parë të procesit të implementimit dhe zhvillimit të sistemeve të menaxhimit të çështjeve dhe të arkivit digjital, që do shërbejnë në drejtim të mirëorganizimit dhe lehtësimit të të gjithë procesit të punës në institucion.

- Konsolidimit të bashkëpunimit me ISKK-në, me fokus të veçantë çështjet që kanë të bëjnë me aksesimin e arkivave nga të dy institucionet;

- Vijimit të procesit të informimit, me qëllim rritjen e ndjeshmërisë publike ndaj krimeve të komunizmit, përmes aktiviteteve, botimeve dhe, në veçanti, pjesëmarrjes në media dhe rrjetet sociale, duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që ato luajnë në drejtim të transparencës dhe sqarimit të opinionit publik..

Kuvendi i kërkon Qeverisë që për vitin 2019 e në vijim:

- Të ketë në vëmendje forcimin e kapaciteteve administrative dhe krijimin e infrastrukturës logjistike të domosdoshme për zhvillimin e veprimtarisë së Autoritetit, në përputhje me përcaktimet që parashikon ligji.

Miraturar në datën 8.5.2019.

KRYETAR
Gramoz Ruçi



**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
BANKËS SË SHQIPËRISË
PËR VITIN 2018**

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njohur rolin e pazëvendësueshëm që ka Banka e Shqipërisë në zhvillimin dhe rritjen e qëndrueshme të ekonomisë dhe sistemit financiar të vendit;

- Duke mbajtur në konsideratë që përkushtimi me transparencë ndaj interesit publik, pavarësia institucionale dhe profesionalizmi janë garantitë më të mëdha për përmbushjen e misionit dhe detyrave të Bankës së Shqipërisë;

- Duke vlerësuar e mirëpritur angazhimin e Bankës së Shqipërisë për respektimin e objektivave dhe detyrave të saj ligjore, si dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave të punës dhe përvetësimin e standardeve më të mira të bankingu qendror;

- Duke besuar se ky përkushtim i shërben zhvillimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë të vendit, transparencës, si dhe edukimit të publikut dhe orientimit të aktivitetit ekonomik e financiar të tij;

Vlerëson pozitivisht veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë për vitin 2018 dhe politikat e ndjekura prej saj në drejtim të:

- Përmbushjes me përkushtim dhe profesionalizëm të detyrave kushtetuese dhe ligjore gjatë vitit 2018, të pasqyruara edhe nga trendi pozitiv i zhvillimeve ekonomike e monetare të vendit.

- Zbatimit të një politike monetare me synime stimuluese në funksion të përmbushjes së objektivit të saj primar, në funksion të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve dhe në funksion të krijimit të një mjedisi financiar likuid, me norma të ulëta interesi dhe luhatje të pakta në tregjet financiare.

- Ndjekjes në vazhdimësi të problematikave të lidhura me mbiçmimin e kursit të këmbimit të monedhës vendase dhe efektet e këtij mbiçmimi në secilën prej kategorive të risqeve.

- Përpjekjeve në drejtim të zgjerimit të tregjeve financiare dhe sistemeve të pagesave, administrimit të rezervës valutore dhe monedhës kombëtare dhe përpunimit të statistikave.

- Mbështetjes së procesit të integritetit evropian të vendit, si dhe vijimin e procesit të përafrimit të rregulloreve dhe procedurave të brendshme institucionale me ato të sistemit evropian të bankave qendrore.

Kuvendi, për vitin 2019, i rekomandon Bankës së Shqipërisë:

- Të zbatojë Strategjinë e Politikës Makroprudenciale, e cila, siç referohet nga raportimi

në Kuvend, synon ndërmarrjen e veprimeve për parandalimin dhe trajtimin e rrezikut sistematik, në funksion të garantimit të një sistemi financiar të qëndrueshëm dhe të suksesshëm.

- Të vijojë politika e deeuroizimit, duke bërë paralelisht edhe vlerësimin e ecurisë dhe afateve të zbatimit të kësaj politike dhe në funksion të transparencës të bëhen publike konkluzionet e vlerësimit, në mënyrë që të mund të shërbejnë si orientuese për grupet e interesit.

- Të zbatojë dhe të monitorojë në vijimësi planet e miratuara të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për çdo bankë, në funksion të realizimit të mandatit të Bankës, që i njeh ligji nr. 133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”.

- Të identifikojë faktorët dhe veprimet e nevojshme që duhen ndërmarrë për të bërë të mundur parashikimin e kthimit të normës së inflacionit pranë objektivit. Në funksion të parashikimeve të lidhura me normën e inflacionit, të identifikohet qartë objektivi në përqindje dhe të detajohet në terma kohorë parashikimi për periudhën e konsideruar “afatmesme”.

- Të monitorojë në vazhdimësi treguesit kryesorë të shëndetit të sektorit bankar, të tilla si likuiditeti, kapitalizimi dhe rentabiliteti dhe vijimin e organizimit të stres-testeve për të siguruar në vazhdimësi rezistencën e sektorit bankar ndaj goditjeve të mundshme.

- Të bëhet analiza e rritjes së portofoleve të kredisë sipas sektorëve, duke detajuar rritjet sektoriale të kredisë me risqet e sektorëve për të identifikuar radhën prioritare të inspektimeve të lidhura me riskun më të lartë.

- Të monitorohet në vazhdimësi situata te bankat që gjatë vitit 2018 kanë realizuar transaksione tregtare të formës bashkim me përthithje dhe studimin e fenomenit nga këndvështrimi i analizës së tregut bankar, për të nxitur efektet pozitive dhe minimizuar ato të padëshiruara, si dhe vlerësimin nëse ky proces do të vijojë dhe do të prekë edhe banka të tjera.

- Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë të marrë në shqyrtim zbatimin e Kodit të Etikës nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, për të standardizuar rregullat e sjelljes dhe përfaqësimit publik të institucionit, në përputhje edhe me dispozitat e miratuara nga Kuvendi në lidhje me Manualin e Monitorimit Vjetor dhe Periodik, për pjesën që i takon kësaj çështjeje.

- Të ndërmarrë hapa konkretë dhe të ofrojë bashkëpunim dhe ekspertizë me autoritetet e tjera mbikëqyrëse të tregjeve, për të krijuar sinergji pozitive, e cila rrit sigurinë e sistemit financiar dhe promovon konkurrencën e drejtë midis të gjitha segmenteve të tij.



- Të ndërmarrë hapa konkretë dhe të ofrojë bashkëpunim dhe ekspertizë me autoritetet e tjera mbikëqyrëse të tregjeve, për të shqyrtuar mundësitë e investimit dhe duke identifikuar llojet e investimeve, të cilat, nga këndvështrimi i mbikëqyrësit të tregut bankar, në kushtet aktuale, konsiderohen me risk të lartë.

- Të vijojë punën për edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut lidhur me rreziqet që paraqet përdorimi dhe investimi në krypto-monedha (para virtuale), si dhe të marrë masa për parandalimin e lindjes ose zhvillimit në tregjet financiare, të skemave spekulative mashtruese në krypto-monedha, duke instaluar një mekanizëm edhe për matjen e efekteve të veprimtarive ndërgjegjësuese.

- Të nxisë politikat e bankave në lidhje me edukimin e publikut për produktet bankare, si dhe të monitorojë, të verifikojë dhe të standardizojë procedurat bankare të ofrimit të shërbimeve bankare në përgjithësi.

- Të nxisë kredidhënien dhe në funksion të kredidhënies (nëpërmjet përgatitjes dhe vënies në dispozicion të të dhënave tabelore si anekse të kontratave të kredisë bankare), të sigurojë ofrimin e plotë të gjithë informacionit të domosdoshëm e të detajuar për sa i takon detyrimit që shtetasit, personat fizikë ose juridikë, do të marrin përsipër si rezultat i sigurimit të kredisë.

- Të shqyrtojë efektet e veprimtarive të ndërmarrë në vite, me qëllim rritjen e kuptueshmërisë së politikës monetare dhe forcimin e besueshmërinë publike të institucionit, për sa i takon fushatave sensibilizuese të deklaruara dhe të raportuara në kuadër të edukimit të publikut në lidhje me termat “lek i ri” dhe “lek i vjetër”, duke instaluar një mekanizëm për matjen e efekteve të veprimtarive ndërgjegjësuese.

- Në funksion të rritjes së transparencës, të mos kufizohet vetëm në aktivitete që nxisin transparencën e veprimtarive të Bankës së Shqipërisë, por të përmirësojë cilësinë dhe thellësinë e analizave profesionale që u vihen në dispozicion publikut dhe grupeve të ndryshme të interesit, me qëllim orientimin e tyre të drejtë drejt zgjedhjeve dhe investimeve të shëndetshme.

Miraturar në datën 8.5.2019.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

UDHËZIM

Nr. 1, datë 6.5.2019

PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË NDARJES SË KUOTAVE VJETORE TË IMPORTIT TË SUBSTANCAVE TË KONTROLLUARA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 35 dhe nenit 70, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, dhe të pikës 1, të kreut VI, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 9.1.2019 “Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substance”,

UDHËZOJ:

1. Ndarja e kuotës vjetore për importin e substancave të kontrolluara të përfshira në aneksin C, të grupit I, të shtojcës 1, bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 9.1.2019, “Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substanca”, bëhet midis subjekteve të interesuara sipas viteve kalendarike përkatëse dhe Diagramit të Kuotave Vjetore të përcaktuar në shtojcën 4, të VKM-së nr. 10/2019.

2. Kuota vjetore e importit, e përcaktuar në shtojcën 4, të VKM-së nr. 10/2019, shpërndahet ndërmjet subjekteve të licencuara me kodin III.3, që aplikojnë në Ministri, duke mbajtur në konsideratë respektimin e rregullave për shmangien e monopolit. Në asnjë rast, kuota e plotë e importit nuk i lëshohet një subjekti të vetëm.

3. Aplikimi për kuotë importi nga subjektet bëhet 1 (një) herë në vit, për kuotë importi vjetore.

4. Kur në të njëjtën kohë në ministri aplikojnë më shumë se një subjekt, kuota vjetore e importit në dispozicion, kur është e mundur, shpërndahet në mënyrë të barabartë ose të përafërt midis subjekteve të interesuara. Në çdo rast, ndarja e kuotës shpërndahet dhe bazohet në një llogaritje të



thjeshtë matematikore që përfshin numrin e subjekteve që kanë aplikuar, çfarë sasia kanë kërkuar dhe sa është sasia në total e lejuar që mund të importohet për Shqipërinë për vitin në fjalë.

5. Kuota vjetore për importin e hidrokloroflorokarboneve (HCFC-ve) në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, edhe kur këto substanca gjenden në përzierje, bëhet sipas përcaktimeve të shtojcës 4, të VKM-së nr. 10, datë 9.1.2019, “Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substanca”.

6. Subjektet e licencuara për ushtrimin e veprimtarisë së importit të substancave të kontrolluara sipas kategorisë III.3, për çdo sasi që importojnë brenda kuotës vjetore, duhet të dorëzojnë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, dokumentet si më poshtë vijon:

a) kërkesën për t'u pajisur me autorizim për kuotë importi për substancat ozonholluese. Kërkesa duhet të përmbajë në mënyrë të saktë dhe të plotë të dhënat e specifikuara në autorizimin për pajisje me kuotë importi për substancat ozonholluese, të përcaktuar në shtojcën 1/a, të këtij udhëzimi;

b) kopjen e licencës “Për importin e substancave ozonholluese”, kodi III.3;

c) formularin e plotësuar të njoftimit të importit të substancave të kontrolluara, sipas shtojcës 8, të VKM-së 10/2019;

d) vetëdeklarim lidhur me përmbushjen e detyrimeve të raportimit sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 10/2019;

e) kopje të raportimit të dorëzuar pranë ministrisë dhe Njesisë Kombëtare të Ozonit, në përputhje me pikën 3, të kreut XI, të VKM nr. 10/2019.

7. Afati i shqyrtimit të dokumentacionit për dhënien e autorizimit, sipas pikës 16, të këtij vendimi, është 20 (njëzet) ditë pune nga data e marrjes së kërkesës. Ministria mund t'i kërkojë subjektit aplikues plotësim të dokumentacionit.

8. Subjekti duhet të paraqesë dokumentacionin plotësues brenda 5 (ditëve) punë nga data e marrjes së njoftimit. Afati 5-(ditor) për plotësim dokumentacioni nuk përlllogaritet në afatin prej 20 (njëzet) ditësh.

9. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit brenda 5 (pesë) ditëve punë, nga data e marrjes së kërkesës për autorizim për “Kuotë importi të substancave të kontrolluara”, e përcjell për mendim kërkesën pranë Njesisë Kombëtare të Ozonit (NJKO).

10. NJKO-ja, jep mendimin e saj me shkrim dhe e përcjell pranë ministrisë brenda 5 (pesë) ditëve punë, nga dita e marrjes dijeni.

11. Drejtoria përgjegjëse e politikave në fushën e substancave ozonholluese, shqyrton aplikimin dhe mendimin e NJKO-së dhe harton aktin e miratimit/refuzimit të kërkesës brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së mendimit të NJKO, sipas shtojcave 1/a dhe 1/b, të këtij udhëzimi.

12. Miratimi i kërkesës për import të kuotave të substancave të kontrolluara, është i vlefshëm për një afat kohor prej 3 (tre) muajsh, nga data e lëshimit të tij. Një kopje e autorizimit “Kuotë importi të substancave të kontrolluara”, Ministria ja përcjell Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

13. Çdo subjekt importues brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike pas mbarimit të afatit tre mujor duhet të njoftojë zyrtarisht Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe NJKO-ja për zbatimin ose jo të autorizimit të marrë.

14. Mosnjoftimi sipas pikës 13, më sipër dhe mos raportimi sipas përcaktimeve të pikës 3, kreut XI të VKM-së nr. 10/2019, përbën shkak për refuzimin e kërkesave pasardhëse për kuotë importi të Substancave të Kontrolluara.

15. Drejtoria përgjegjëse e Politikave në fushën e substancave ozonholluese, krijon dhe mban regjistrin lidhur me subjektet aplikues, autorizimet e kuotës së importit të lëshuara ose të refuzuara dhe çdo të dhënë tjetër lidhur me këtë proces.

16. Lista e subjekteve importues dhe miratimet përkatëse për importin e substancave të kontrolluara publikohen në faqen e internetit të ministrisë përgjegjëse për mjedisin.

17. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet, Drejtoria përgjegjëse e Politikave në fushën e substancave ozonholluese.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Blendi Klosi



Shtojca 1/a



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRI**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2019

**AUTORIZIM PËR PAJISJE ME KUOTË IMPORTI TË SUBSTANCAVE
OZONHOLLUESE**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 9.1.2019 “Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substance”, **miratohet** ky autorizim për pajisje me kuotë importi të substancave ozonholluese, me të dhënat si më poshtë:

1. Nr.autorizimit:
2. Të dhëna mbi personin fizik/juridik importues:

Emri i personit fizik/juridik që importon:
Numri i Kodit të Regjistrimit të Importuesit (Kodi UNIK):.....
NIPT:
Adresa (qyteti, rruga nr. etj.):
Nr. telefoni : Fax ose e-mail:
Emri i drejtuesit teknik:

3. Të dhëna mbi substancën ozonholluese që importohet, ose që përmbahet në produktin që importohet:

Emri i substancës:
Kodi tarifar:
Formula kimike,
Simboli

4. Sasia në kilogramë e substancës ozonholluese që importohet:

5. Sasia në kilogramë e substancës ozonholluese që përmbahet në njësinë e produktit që importohet:

Shënim: të sqarohet mënyra se si do të bëhet transporti i substancës ozonholluese, çfarë pajisjesh do përdoren dhe kapaciteti i tyre.

6. Përshkrimi i qëllimit të përdorimit:

- a) për mbrojtjen e jetës së njerëzve/bimëve/kafshëve etj.
- b) për mbrojtjen kundër zjarrit
- c) për sigurinë e transportit
- d) për qëllim të kërkimeve shkencore
- e) të tjera:.....



7. Të dhëna mbi shoqërinë tregtare nga e cila blihet substanca ozonholluese ose produkti që e përmban atë:

Emri i shoqërisë tregtare:

Adresa (shteti, qyteti, rruga, nr. etj.):

Nr. telefoni:

Fax ose e-mail:

8. Shteti nga importohet substanca ozonholluese ose produkti që e përmban atë:

9. Përdoruesi i fundit i substancës ozonholluese:

.....

10. Përdoruesi i fundit i produkteve që përmbajnë substanca ozonholluese

.....

.....

11. Autorizimi i kuotës së importit për substancën ozonholluese të sipërcituar, është i vlefshëm për një afat kohor 3 (tre) muaj, nga data e lëshimit më ____/____/____2019 deri më datë ____/____/2019.

Personi fizik/juridik “.....” mban përgjegjësitë ligjore të parashikuara në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 9.1.2019 “Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substance”, për importin e substancave ozonholluese për të cilin lëshohet ky autorizim.

MINISTËR
EMËR MBIEMËR
(firma, vula)



Shtojca 1/b



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

Nr. _____ prot.

MINISTRI

Tiranë, më _____.____.2019

AKT REFUZIM PËR PAJISJE ME KUOTË IMPORTI TË SUBSTANCAVE
OZONHOLLUESE

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 9.1.2019 “Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substance”, **refuzohet** pajisja me kuotë importi të substancave ozonholluese me të dhënat si më poshtë:

1. Nr. i refuzimit:

2. Të dhëna mbi personin fizik/juridik që kërkon të importojë:

Emri i personit fizik/juridik që importon:

Numri i Kodit të Regjistrimit të Importuesit (Kodi UNIK):.....

NIPT:

Adresa (qyteti, rruga nr., etj.):

Nr. telefoni : Fax ose e-mail:

Emri i drejtuesit teknik :

3. Të dhëna mbi substancën ozonholluese që kërkohet të importohet, ose që përmbahet në produktin që kërkohet të importohet:

Emri i substancës:

Kodi tarifor:

Formula kimike,

Simboli

4. Sasia në kilogramë e substancës ozonholluese që kërkohet të importohet:

5. Sasia në kilogramë e substancës ozonholluese që përmbahet në njësinë e produktit që kërkohet të importohet:

Shënim: të sqarohet mënyra se si do të bëhet transportimi i substancës ozonholluese, çfarë pajisjesh do përdoren dhe kapaciteti i tyre.

6. Përshkrimi i qëllimit të përdorimit:

a) për mbrojtjen e jetës së njerëzve/bimëve/kafshëve etj.

b) për mbrojtjen kundër zjarrit

c) për sigurinë e transportit



- d) për qëllim të kërkimeve shkencore
e) të tjera:.....

7. Të dhëna mbi shoqërinë tregtare nga e cila parashikohej të blihej substanca ozonholluese ose produkti që e përmban atë:

Emri i shoqërisë tregtare:

Adresa (shteti, qyteti, rruga, nr. etj.):

Nr. telefoni:

Fax ose e-mail:

8. Shteti nga i cili do importohet substanca ozonholluese ose produkti që e përmban atë:
.....

9. Arsyet e refuzimit:

a)

b)

MINISTËR
EMËR MBIEMËR
(firma, vula)

URDHËR
Nr. 185, datë 30.4.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

I. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Sekretarit të Përgjithshëm, për çështjet të mëposhtme:

1. Të nënshkruajë autorizimet për përfaqësim ligjor të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha shkallët e gjyqimit, duke përfshirë kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadi, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe

përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjyqimit të kësaj çështjeje, si dhe t’i nënshkruajë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga sekretari i përgjithshëm, i përcaktua sipas kësaj pike, ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit.

2. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit.

4. Të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon shprehimisht ministrit.

5. Të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër nga ministri.

II. Këto kompetenca do të ushtrohen nga Sekretari i Përgjithshëm me hyrjen në fuqi të këtij urdhri.



III. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe të gjithë nëpunësit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 13, datë 6.3.2019

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË
SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË
NDOTURA PËR SHOQËRINË
UJËSJELLËS-KANALIZIME
DELVINË SHA**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015 “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 39), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015 “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015 “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,
në mbledhjen e datës 6.3.2019 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjiellës-Kanalizime Delvinë sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

VËREN SE:

1. Shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime Delvinë” (UK Delvinë) me shkresën nr. 106 prot., datë 29.5.2018 “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për rritjen e tarifave në zonën e shërbimit për të tria kategoritë e konsumatorëve të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe vendimin nr. 40.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifë fikse të shoqërisë UK Delvinë në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me vendimin nr. 60, datë 6.9.2018 vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Delvinë për nivelin e ri tarifor për shërbimet UK për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit në zbatim të VKM nr. 63, datë 27.1.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.”

3. UK Delvinë, nëpërmjet shkresës nr. 106 prot. datë 29.5.2018, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” për të tre kategoritë e konsumatorëve ka paraqitur tarifat e propozuara si në tabelën e mëposhtme.



Tabela me tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria sipas kategorisë së konsumatorëve

Kategoritë e Konsumatorëve	Tarifat aktuale		Tarifat e propozuara	Diferenca
	Zona para riorganizimit	NJA Vergo* dhe fshatrat Vanë, Letftherhor, Kakodhiq **	Zona e shërbimit	Zona para riorganizimit
A. Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³
1. Konsumatorë familjarë	48	-	58	+10
2. Konsumatorë publik	100	-	120	+20
3. Konsumatorë privat	100	-	120	+20
B. Tarifë volumetrike për KUN	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³	Lek/m³
1. Konsumatorë familjarë	16.7	-	18	+1.3
2. Konsumatorë publik	33.7	-	35	+1.3
3. Konsumatorë privat	33.7	-	35	+1.3
C. Tarifë fikse e shërbimit	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje	Lek/muaj/lidhje
1. Konsumatorë familjarë	167	722 *	167	0
2. Konsumatorë publik	200	-	200	0
3. Konsumatorë privat	200	-	200	0

*Tarifë flat mujore për klientët e NJA Vergo pa matës. Kjo tarifë sipas propozimit nuk do të aplikohet pasi për klientët pa matës do të aplikohet faturimi volumetrik me 150 litra/ditë /frymë.

**Fshatrat e tjerë të shtuar në zonën e juridiksionit nuk kanë shërbim nga UK Delvinë.

4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezultojnë se treguesit e arritur të performancës për vitin 2017 dhe objektivat e propozuara nga shoqëria UK Delvinë për vitin 2019 janë sipas tabelës së mëposhtme:

Treguesit e performancës	Njësia	Treguesit e performancës Viti 2017	Objektivat e propozuara nga shoqëria Viti 2019
Uji pa të ardhura	%	51.6	52.5
Mbulimi i kostove OM	%	67	82
Mbulimi i kostove totale	%	59	71
Niveli i matjes	%	41.6	65
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	8	9
Eficienta e stafit	Staf/1000lidhje	6.4	6.2
Mbulimi me ujë	%	68	68
Mbulimi me KUN	%	36.6	36.5
Norma e arkëtimit	%	80	82



a) Treguesi ujë pa të ardhura për vitin 2017 është në nivelin 51.6%. Sasia e ujit të prodhuar është 558,700 m³ ujë. Humbjet administrative janë 36.9% e humbjeve totale ndërsa ato reale 63.1% e tyre.

b) Për vitin 2019 shoqëria parashikon që niveli i humbjeve të jetë në të njëjtat nivele por pas analizës, në mënyrë që të përmirësojë këtë tregues shoqërisë i duhet të:

- reduktojë humbjet e shkaktuara nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmissiionit dhe shpërndarjes nga 21 mijë m³ në 6 mijë m³;

- saktësojë maksimalisht vlerësimin e sasisë së ujit të prodhuar i cili do të reflektohet në “pasaktësia në matje për ujin e prodhuar” duke korigjuar atë me rreth 6 mijë m³ ujë;

- reduktojë humbjet fizike në masën 5% të atyre ekzistuese (rreth 9,000 m³) duke reaguar në kohën e duhur ndaj defekteve në sistem, si dhe nëpërmjet manaxhimit më të mirë të presionit maksimal në rrjet i cili i shkakton humbje të mëdha dhe defekte.

Nëse do të merren në konsideratë ndryshimet e mësipërme niveli i humbjeve për vitin 2019 reduktohet në 47%.

c) Mbulimi i kostove të O&M. Për vitin 2019 nevoja për të ardhura synon përmirësimin e nivelit të mbulimit të kostove O&M nga rreth 67.1% që është në vitin 2017 në 82%. Mbulimi 100% i kostove O&M do të përbënte një kërcim mjaft të madh të vlerës së faturës për konsumatorët familjarë me rrezikun e pasojave negative nga një reaksion në masë për mospagim të faturës së ujit nga ana e tyre.

d) Niveli i matjes. Nga informacioni i fundit i marrë nga shoqëria, në kuadër dhe të nismave të qeverisë për reformën në ujësjellës, raportohen se vetëm gjatë muajve Tetor-Nëntor 2018 janë instaluar 200 matës në dy fshatra si dhe një matës në prodhim. Nisur nga ky fakt niveli i matjes për vitin 2018 llogaritet në 52% kundrejt 41.6% që ishte në vitin paraardhës. Shoqëria nuk ka kapacitete financiare me qëllim që të prokurojë sasi të konsiderueshme matësish e më pas të paguhen nga klientët në momentin e instalimit. Edhe matësit që janë vendosur dhe parashikuar të vendosen gjatë vitit 2019 i takojnë kryesisht klientëve familjarë inaktiv të cilët janë të detyruar të paguajnë vetëm tarifën fikse me konsum zero që do të çojë nivelin e matjes në 65%.

ERRU-ja, duke marrë në konsideratë ritmet e fund vitit 2018 në instalimin e matësve dhe duke e shtrirë këtë ecuri në të gjithë vitin 2019 gjykon se shoqëria shërbimin e matur do ta çojë në 70% nga 65% që e ka parashikuar vetë.

e) Aktualisht, vazhdimësia e furnizimit me ujë është mesatarisht 8 orë në ditë. Në disa zona shërbimi ofrohet 2 orë në ditë, kurse në disa zona të tjera konsumatorët përfitojnë 24 orë/ditë. Investimet që parashikohen të kryhen gjatë vitit 2019 do të japin efektin në vitet pasardhëse. Megjithatë shoqëria ka vënë si objektiv të vitit 2019 rritjen me një orë në ditë të nivelit të këtij treguesi, duke menaxhuar mirë nevojat për ujë, reduktuar lidhjet e paligjshme, si dhe riparuar defektet brenda standarteve të përcaktuara.

f) Efikasiteti i stafit. Shoqëria edhe pse ka shtuar popullsinë në zonën e shërbimit me 1,336 banorë, nuk ka ndryshuar numrin e stafit, pra kryen aktivitetin me 29 punonjës staf drejtues dhe operues, për të mos rënduar më tej me kosto shtesë, si edhe duke përmirësuar ndarjen e ngarkesës shtesë të punës me stafin aktual. Edhe për vitin 2019 nuk do të ketë ndryshim të numrit të punonjësve.

Mbajtja konstante e stafit si dhe rritja e pandjeshme e numrit të lidhjeve UK bën që ky tregues për vitin 2019 të jetë në nivelin 6.2 punonjës/1000 lidhje UK nga 6.4 që ishte në vitin 2017.

g) Sha UK Delvinë raporton se popullsia totale në zonën e juridiksionit është 18,636 banorë dhe treguesi mbulimi me ujë është 68% në vitin 2017. Edhe pse zona në juridiksion shtohet, mbulimi me shërbim vetëm për këto zona mbetet shumë i ulët, në nivele 27.4% kështu që ky tregues ka rënë krahasuar me periudhën para riorganizimit. Për vitin 2019 ky tregues do të mbetet pothuajse në të njëjtat nivele me vitin paraardhës me ndryshim të papërfillshëm.

h) Mbulimi me kanalizime të ujërave të ndotura. Shoqëria mbulon me shërbimet e KUN-it vetëm 70% të popullsisë së qytetit të Delvinës. Kjo pjesë e popullsisë përbën 36.5% të të gjithë popullsisë në juridiksionin e Bashkisë Delvinë. Për vitin 2019 ky tregues nuk do të ndryshojë sepse nuk janë planifikuar investime në rrjetin e KUZ.



i) Treguesi Norma e Arkëtimit për vitet 2017–2018 është 80%, ndërsa për vitin 2019 parashikohet të jetë 82%, pasi në zonat rurale niveli i mbledhjes së të ardhurave mbetet 75% kështu. Gjatë vitit 2018 shoqëria ka rritur performancën në drejtim të arkëtimit të debive të prapambetura duke përmirësuar treguesin e normës së përgjithshme të arkëtimit. Duke konsideruar punën e nisur për arkëtimin e faturave të prapambetura dhe nëse shoqëria do të punojë intensivisht me arkëtimin e faturave korrente, niveli i Normës së arkëtimit për vitin 2019 duhet të jetë 84%.

5. Nevoja e ndryshimit të tarifave nga ana e UK Delvinë argumentohet:

a) Pas zgjerimit të zonës së shërbimit Shoqëria aplikon për herë të parë sipas metodologjisë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr. 42, datë 9.12.2015, bazuar në analizën e gjendjes teknike dhe ekonomike të saj, konkretisht analizën e kostove dhe të ardhurave për shërbimet e ofruara, analizën dhe përcaktimin e objektivave për treguesit e performancës.

b) Shoqëria ka një performancë të dobët financiare, ku kostot e shërbimeve UK mbulohen në masën 67% me të ardhurat e faturuara për këto shërbime. Shoqëria krahas përpjekjeve për mirë menaxhim në drejtim të mbajtjes nën kontroll të kostove si dhe rritjes së eficiencës së mbledhjes së të ardhurave e ka të domosdoshme ndryshimin e tarifave me qëllim gjenerimin e të ardhurave shtesë për përballimin e kostove të domosdoshme dhe të justifikuar.

c) Shtimi i zonave të reja në zonën e shërbimit ka sjellë nevoja për investime fizike duke qenë se edhe treguesit e performancës janë në nivele të dobëta, ku uji pa të ardhura është 51.6%, mbulimi me shërbimet e furnizimit me ujë është 68% dhe mbulimi me kanalizime është 36.6%.

d) Sigurimi i tarifave më të larta nga shoqëria për shërbimin UK, për të plotësuar objektivat e vendosura nga KfW-ja, me qëllim përfitimin e financimit nga projektet e tyre. Fondi që UK Delvinë do të përfitojë nga KfW-ja do të përdoret për rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit të qytetit Delvinë. Gjithashtu dhe Banka Zvicerane ka parashikuar të investojë për shërbimet e

konsulencës si dhe të infrastrukturës që ka të bëjë me sistemin kompjuterik të faturimit të shërbimeve UK.

e) Shoqëria ende ka nevojë për subvencione nga qeveria për shlyerjen e faturave të energjisë elektrike si dhe të detyrimeve të tjera të prapambetura, por dhe të përballimit të kostove të tjera të vitit.

6. ERRU-ja, gjatë procesit të analizës teknike ekonomike sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr. 42, ka kërkuar nga UK Delvinë informacion shtesë si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave, të cilat janë vënë në dispozicion.

7. ERRU-ja, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Delvinë të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo e kushteve të tjera të tregtimit;

c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar (ligji nr. 9902);

d) Orientimin drejt mbulimit të kostove O&M në nivelin 82% pasi aktualisht shoqëria bën pjesë në grupin e shoqërive që mbulon 67% të këtyre kostove.

e) Tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përballueshmërinë, sipas të cilit tarifatat duhet të jenë të përballueshme.

f) Tarifatat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen.

g) Nivelin tarifor të propozuar nga shoqëria, ERRU-ja, e gjen të justifikuar për sa u përket tarifave volumetrike për dy shërbimet ujë dhe kanalizime si dhe tarifën fikse të shërbimit.



8. ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës dhe për këtë rekomandon:

- Të hartojë Bilancin e Ujit të saktë duke vlerësuar dhe llogaritur në mënyrë të saktë të gjithë nën zërat e tij, si dhe të dhënat e raportuara nga Departamenti i Klientëve të jenë në përputhje me ato të bilancit të ujit nga dega teknike.

- Të instalojë matësit në prodhim si dhe në konsumatorët familjarë e jo familjarë.

- Shoqëria ka një plan biznesi (2017–2021), por që nuk është i përditësuar me ndryshimet e ndodhura në kuadër të riorganizimit të shoqërisë sipas VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016. Detyrimit brenda vitit 2019 shoqëria duhet të ripunojë Plan Biznesin në përputhje me formatin e AKUM-së gjë që kërkon nevojën e ripunimit në themel të këtij dokumenti kaq të rëndësishëm dhe të domosdoshëm.

- Shoqëria duhet të mbajë në kontabilitet të ndara me qendra kostojë shërbimet që ofron ujë dhe kanalizime me qëllim që dhe tarifatat të orientohen drejt kostove.

- Shoqëria duhet të hartojë një plan kontrolli dhe disiplinimi të konsumatorëve abuziv dhe lidhjeve të paligjshme.

- Shoqëria duhet të evidentojë klientët problematik si dhe të hartojë një plan masash të detajuar për vjeljen e debive të prapambetura.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifatat e propozuara nga operatori mbi bazën e Metodologjisë të miratuar me vendim nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura” si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifatat e propozuara sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara si dhe përbalueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Delvinë si më poshtë:

Kategoria	Tarifat në zonën e riorganizuar		
	Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	Tarifë volumetrike për KUN	Tarifë fikse
	Lek/m ³	Lek/m ³	Lek/muaj/lidhje
Konsumatorë familjarë	58	18	167
Konsumatorë publik	120	35	200
Konsumatorë privat	120	35	200

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës të vitit 2019 për shoqërinë UK Delvinë të jenë:

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Niveli i objektivit të përcaktuar nga ERRU-ja
Uji pa të ardhura	%	47
Mbulimi i kostove O&M	%	82
Mbulimi i kostove totale	%	71
Niveli i matjes	%	70
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	9
Eficienta e stafit	staf/1000 lidhje	6.2
Mbulimi me ujë	%	68
Mbulimi me KUN	%	36.5
Norma e arkëtimit korente	%	84



3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Delvinë sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Delvinë brenda 30 ditëve nga data e njoftimit sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Vendimi nr. 12, datë 29.5.2008 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. U Delvinë” shfuqizohet.

6. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.5.2019 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 18, datë 19.4.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PROCEDURA E ANKIMIT NË
KOMISIONIN KOMBËTAR
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT
E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË
NDOTURA, PËR NJË TË LICENCUAR”

Në mbështetje të nenit 13, pika 1/I, të nenit 14, neni 28, nenit 29 dhe nenit 30, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar (ligji nr. 8102); ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 44/2015), neni 9 e vijues i rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura (rregullore e brendshme)

Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e datës 19.4.2019, pasi shqyrtoi çështjen në rend dite Miratimi përfundimtar i projekt aktit administrativ Rregullore “Procedura e ankimit në Komisionin Kombëtar Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, për një të licencuar”, sipas dokumentacionit të paraqitur:

1. Projektakti rregullorë “Procedura e ankimit në Komisionin Kombëtar Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, për një të licencuar” (projektakti);

2. Relacioni mbi projekt aktin rregullorë “Procedura e ankimit në Komisionin Kombëtar Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, për një të licencuar” (relacioni);

3. Projekt akti administrativ vendimmarrës për miratimin e projekt aktit (projektvendimi),

VËREN SE:

1. Projekt akti nxirret nga KKRR-ja në mbështetje të kompetencës ligjore të parashikuar në pikën 1/i, të nenit 14, të ligjit nr. 8102, sipas të cilit KKRR-ja për të përmbushur mandatin e tij sipas këtij ligji, ka kompetentë të nxjerri rregulla për të ndihmuar ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të parashikuara në këtë ligj.

Nxjerrja e projekt aktit bazohet edhe në kompetencën e ERRU-së të përcaktuar në nenin 29, të ligjit nr. 8102, sipas të cilit ERRU-ja miraton rregullat procedurale që, do të përdorë për kryerjen e funksioneve që i jep ky ligj. Këto rregulla përmbajnë:

...ii) skedimin e aplikimeve, ankesave dhe kërkesave të tjera që i janë dorëzuar komisionit....

2. Në nenin 30, të ligjit nr. 8102, lidhur me ankesat përcaktohet e drejta e çdo personi të interesuar për t'i dërguar Komisionit një ankesë me shkrim për një të licencuar, për të cilin mendon se ka shkelur dispozitat e ligjit nr. 8102, apo të ndonjë urdhri, rregulli, licence apo udhëzimi të nxjerrë sipas këtij ligji. Gjithashtu, në këtë dispozitë ligjore përcaktohet detyrimi i Komisionit për të njoftuar menjëherë të licencuarin me anë të një njoftimi me shkrim për ankesën dhe t'i lërë atij mundësinë për t'iu përgjigjur me shkrim. Si dhe, procedura e ankimit bëhet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Kjo nënkupton që procedura që duhet të zbatohet nga palët, ankimesi si person i interesuar dhe Komisioni si organi administrativ që mbart detyrimin ligjor të shqyrtimit të ankesës, si dhe i licencuari si subjekti ndaj të cilit



drejtohet ankesa, duhet të bazohet në përcaktimet e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative si ligj i përgjithshëm.

3. Kodi i Procedurave Administrative në fuqi në Republikën e Shqipërisë është ligji nr. 44/2015. Procedura administrative për paraqitjen e ankesës në Komision dhe shqyrtimin e ankesës nga Komisioni bazohet tërësisht në ligjin nr. 44/2015.

4. Qëllimi i këtij projekt akti është vendosja e një kuadri rregullator për zbatimin e së drejtës që ka çdo person i interesuar për t'i dërguar Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura që udhëheq Entin Rregullator të Ujit (ERRU), një ankesë me shkrim për një të licencuar, për të cilin mendon se ka shkelur dispozitat e ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” të ndryshuar apo të ndonjë urdhri, rregulli, licence apo udhëzimi të nxjerrë sipas këtij ligji.

Objekti kryesor i projekt aktit është informimi i cilësdo palë të interesuar, që në mënyrë transparente, të njohë dhe zbatojë procedurën që do të zbatohet nga organi administrativ kompetent, për ushtrimin e një të drejte themelore siç është e drejta e ankimit.

5. Në nenin 29, të ligjit nr. 8102, pika 1/b përcaktohet që rregullat procedurale që nxjerr ERRU-ja për kryerjen e funksioneve që jep ky ligj të përmbajnë mundësinë për koment publik, duke përfshirë edhe komentet nga ana e Këshillit të Ministrave. Ky përcaktim gjeti zbatim nëpërmjet publikimit të projekt aktit administrativ për këshillim publik në faqen zyrtare të ERRU-së www.erru.al nga data 4.3.2019 deri më datë 4.4.2019.

Për sa më sipër duke qenë në kushtet e plotësimit të kërkesave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 8102 për nxjerrjen e Projektaktit, si dhe të përputhshmërisë së plotë të përmbajtjes së tij me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 44/2015,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores “Procedura e ankimit në Komisionin Kombëtar Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e

përpunimit të ujërave të ndotura, për një të licencuar”, sipas dokumentit bashkëlidhur.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit për zbatimin e kësaj rregullore dhe njoftimin e shoqërive ujësjellës kanalizime për miratimin e kësaj rregullore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

RREGULLORE PROCEDURA E ANKIMIT NË KOMISIONIN KOMBËTAR RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA, PËR NJË TË LICENCUAR

Në mbështetje të germës “i”, të nenit 14, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar,

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

VENDOSI:

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është vendosja e një kuadri rregullator për zbatimin e së drejtës që ka çdo person i interesuar për t'i dërguar Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (Komisioni) një ankesë me shkrim për një të licencuar (operatori), për të cilin mendon se ka shkelur dispozitat e ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” të ndryshuar apo të ndonjë urdhri, rregulli, licence apo udhëzimi të nxjerrë sipas këtij ligji.



Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i procedurës së paraqitjes të ankimit nga personi/pala e interesuar dhe shqyrtimi i tij nga Komisioni në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative në fuqi.

Neni 3 Baza ligjore

1. Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” të ndryshuar, neni 30, i cili përcakton të drejtën e çdo personi të interesuar për t’i dërguar Komisioni, një ankesë me shkrim për një operator të licencuar, (operatori) për të cilin mendon se ka shkelur dispozitat e ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” të ndryshuar apo të ndonjë urdhri, rregulli, licence apo udhëzimi të nxjerrë sipas këtij ligji.

2. Ligji nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative”, i ndryshuar, i cili përcakton rregullat për kërkesën dhe paraqitjen e saj, procedurën administrative që zbatohet, të drejtat dhe detyrimet e palëve në proces, afatet procedurale, efektet dhe pasojat juridike të vendimit të organit administrativ në përfundim të procedurës.

Neni 4 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtat kuptime me ato të përcaktuara në:

a) nenin 2, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar (ligji nr. 8102);

b) nenin 3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar (ligji nr. 44/2015).

2. Me palë në procesin e ankimit do të konsiderohen:

a) personi i interesuar, ankimesi, që nënkupton të tre kategoritë e konsumatorëve për

të cilat ERRU vendos tarifat e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve; dhe

b) operatori, subjekti ndaj të cilit drejtohet ankimi, që ofron shërbimet e ujësjellës kanalizimeve.

Neni 5 Fusha e zbatimit

Kjo rregullore është e zbatueshme nga të gjitha subjektet e licencuara nga Enti Rregullator i Ujit sipas ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar dhe kuadrin rregullator të miratuar nga Komisioni për ushtrimin e veprimtarisë së grumbullimit, shpërndarjes, largimit dhe trajtimit të ujit, për përfitim publik.

KREU II PARIME TË PËRGJITHSHME DHE KOMPETENCA

Neni 6 Parimi i ligjshmërisë

1. Komisioni në zbatimin e procedurës për shqyrtimin e një ankimi nga një person i interesuar për një të licencuar ushtron veprimtarinë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tij dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ përveçse kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.

Neni 7 Parimi i transparencës

Veprimtaria administrative e Komisioni gjatë procesit administrativ për shqyrtimin e një ankimi sipas kësaj rregullore, ushtrohet në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me palët e përfshira në të.



Neni 8

Parimi i mbrojtjes së konfidencialitetit

Pjesëmarrësit në një procedurë administrative të nisur nga Komisioni për shqyrtimin e një ankimi kanë të drejtë të kërkojnë që të dhënat e tyre personale dhe konfidenciale të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 9

Parimi i mbrojtjes së të dhënave

Komisioni ka detyrimin që gjatë përpunimit të ligjshëm e të drejtë të të dhënave personale, të të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale, me të cilat njihet gjatë procedurës administrative dhe që mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndërmarrë masa lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin.

Neni 10

Parimi i drejtësisë dhe paanësisë

Në ushtrimin e funksioneve të tij për shqyrtimin e ankimit Komisioni trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha palët e përfshira në procedurën administrative.

Neni 11

Parimi i kontrollit

Veprimtaria administrative e Komisioni e ushtruar gjatë procedurës administrative për shqyrtimin e ankimit i nënshtrohet:

- a) kontrollit administrativ, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 44/2015 mbi mjetet ligjore administrative dhe legjislacionit në fuqi;
- b) kontrollit të gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi; dhe/ose
- c) çdo kontrolli tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Neni 12

Verifikimi i kompetencës

Me fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e ankimit, Komisioni verifikon nëse ka apo jo kompetencë lëndore dhe tokësore për të vendosur për çështjen objekt shqyrtimi.

Neni 13

Mungesa e kompetencës

1. Kur Komisioni merr një kërkesë për shqyrtim ankimi sipas nenit 30, të ligjit nr. 8102, për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës së vet, ia përcjell ankimin menjëherë, dhe në çdo rast jo më vonë se dy ditë nga marrja e saj, organit publik kompetent dhe njofton ankimuesin për këtë.

2. Afatet për ankimuesin drejtuar Komisionit në rastin e mungesës së kompetencës vlerësohen të respektuara nëse ankimi është paraqitur në kohë pranë Komisionit, ndërsa afatet përkatëse për Komisionin fillojnë të llogariten nga data e marrjes së ankimit.

KREU III

GARANTIMI I PAANSHMËRISË

Neni 14

Pengesat ligjore

Anëtari i Komisionit nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrëse për shqyrtimin e një ankimi, në rastet e përcaktuara në nenin 30, të ligjit nr. 44/2015.

Vetë deklarimi i pengesave ligjore dhe kërkesa për përjashtim zbatohet në përputhje me nenin 31 të këtij ligji.

Neni 15

Vendimmarrja dhe efektet e përjashtimit

Nëse Komisioni përjashton një anëtar për shkak të pengesës ligjore, procedura administrative për shqyrtimin e ankimit vazhdon pa zëvendësuar anëtarin e përjashtuar. Në rastet e përjashtimit Komisioni funksionon si i tillë pa pjesëmarrjen e anëtarit të përjashtuar dhe vendimmarrja bazohet në parashikimin ligjor mbi kuorumin.

KREU IV

PROCEDURA ADMINISTRATIVE DHE AFATET

Neni 16

Forma dhe përmbajtja e ankimit

1. Ankimi paraqitet në Komision nga personi i interesuar në formë të shkruar ose në rrugë



elektronike me kusht që të tregojë qartë autorin e saj.

2. Ankimi duhet të jetë i qartë për të përcaktuar qëllimin e tij.

3. Ankimi konsiderohet në formë të shkruar edhe kur dërgohet me rrugë elektronike.

Neni 17

Paraqitja e ankimit

1. Ankimi paraqitet drejtpërdrejt në ERRU përpara Komisionit.

2. Ankimi mund të dërgohet edhe me postë të porositur, mjete elektronike ose drejtpërdrejt në adresën përkatëse zyrtare të ERRU-së.

Neni 18

Regjistrimi dhe vërtetimi i paraqitjes së ankimit

1. Marrja e ankimit regjistrohet në ERRU, sipas rendit kronologjik të paraqitjes në një regjistër të posaçëm. Regjistri i ankimeve përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) numrin e ankimit;
 - b) datën e dorëzimit;
 - c) objektin e ankimit;
 - d) numrin dhe emërtimin e dokumenteve që i bashkëngjiten ankimit; dhe
 - e) identitetin dhe adresën e ankimuesit
2. Personi që paraqet ankimin, në çdo rast, i lëshohet një vërtetim që konfirmon faktin e pranimin të ankimit, objektin e saj, datën dhe listën e dokumenteve të bashkëlidhura, në se ka të tilla. Depozitimi me postë të porositur vërtetohet nga dokumenti postar që duhet të përmbajë të njëjtat të dhëna.

3. Me kërkesë të personit, në rastin e dërgimit të ankimit me mjete elektronike, vërtetimi sipas pikës 2, të këtij neni, i dërgohet pa vonesë në të njëjtën adresë dhe me të njëjtat mjete, me të cilat është kryer dërgimi.

Neni 19

Fillimi i procedurës administrative

1. Procedura administrative për shqyrtimin e ankimit konsiderohet e filluar me paraqitjen përpara Komisionit të ankimit me shkrim nga personi i interesuar për një operator nga ERRU-

ja sipas ligjit nr. 8102, për të cilin mendon se ka shkelur dispozitat e këtij ligji apo ndonjë urdhri, rregulli, licence apo udhëzimi të nxjerrë sipas këtij ligji.

2. Komisioni, nëpërmjet strukturës përgjegjëse sipas organikës për trajtimin e ankimeve, shqyrton paraprakisht ankimin lidhur me plotësimin e kriterëve formale ligjore, si kompetenca, legjitimiteti, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji dhe në përfundim:

a) Njofton palën kërkuese nëse janë të nevojshme plotësime të tjera lidhur me respektimin e kriterëve formale ligjore, si dhe për veprime të mëtejshme administrative duke caktuar një afat të arsyeshëm për plotësimin e tyre.

b) Mosplotësimi i të metave brenda afatit të përcaktuar përbën shkak për mospranimin e kërkesës. Kundër këtij vendimi pala mund të ankohet sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 44/2015.

Neni 20

Çështjet paraprake

1. Nëse Komisioni gjatë procedurës administrative për shqyrtimin e ankimit përballlet me çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (çështja paraprake), Komisioni pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.

2. Nëse shqyrtimi i çështjes paraprake mund të fillojë vetëm me kërkesë të palës, Komisioni pezullon procedurën, duke njoftuar njëkohësisht palën për të drejtën që ajo ka për të paraqitur kërkesën për çështjen konkrete.

3. Në se zgjidhja e çështjes paraprake kërkon iniciativën kryesisht të organit tjetër publik, Komisioni kërkon fillimin e procedurës nga organi tjetër.



Neni 21

Vendimet e ndërmjetme

1. Komisioni, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme, kur gjykohet se mos marrja e masave të caktuara do të shkaktonte një dëm të rëndë të pariparueshëm mbi interesin publik, apo të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve.

2. Vendimet e ndërmjetme mund të merren me nismën e Komisionit ose me kërkesën e palëve të interesuara.

3. Vendimi për marrjen e masave të ndërmjetme duhet të jetë i arsyetuar, me afat të përcaktuar dhe u njoftohet palëve.

4. Përfundimi i vendimeve të ndërmjetme zbatohet në përputhje me përcaktimet e parashikuara në ligjin nr. 44/2015.

Neni 22

Pajtimi i palëve

1. Gjatë gjithë zhvillimit të një procedure administrative për shqyrtimin e ankimit, Komisioni përpiqet t'i pajtojë palët në procedurë, kur e lejon natyra e çështjes.

2. Akti i pajtimit mes dy ose më shumë palëve bëhet në formë të shkruar dhe pasi të lexohet dhe të nënshkruhet nga palët bëhet i plotfuqishëm. Një kopje e këtij akti u jepet palëve në procedurë.

3. Akti i pajtimit ka efekt të njëjtë me atë të aktit administrativ.

4. Komisioni nuk pranon pajtim mes palëve në qoftë se pajtimi është në dëm të interesit publik ose në dëm të interesave të ligjshëm të personave të tjerë fizikë dhe juridikë.

Neni 23

Kuptimi dhe mjetet e kërkimit të provës

1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni mund:

a) të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët;

b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;

c) të vizitojë dhe të kontrollojë ujin, pajisje apo vende të përfshira.

2. Dispozitat e parashikuara në ligjin për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative mbi mjetet e provave zbatohen për atë që është e mundur në procedurën administrative, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin nr. 44/2015.

3. Faktet tashmë të njohura për ERRU/Komisionin ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.

Neni 24

Paraqitja e informacionit dhe provave

1. Në rastet kur palët janë të detyruara të paraqesin informacion ose prova, pala duhet të njoftohet me shkrim apo në mënyrë verbale, sipas afateve dhe parashikimeve të ligjit nr. 44/2015.

2. Në qoftë se palët nuk i përgjigjen njoftimit, Komisioni mund të bëjë një njoftim të ri ose të vijojë procedurën mbi bazën e gjykimit të tij.

3. Në ato raste kur informacioni apo dokumentet e kërkuara nga palët janë të domosdoshme për shqyrtimin e pretendimit të ngritur nga vetë palët, procedura pezullohet deri në sigurimin e informacionit dhe palët njoftohen për këtë gjë.

Neni 25

Përcaktimi dhe shtyrja e afateve procedurale

1. Afatet për kryerjen e veprimeve procedurale (afati procedural) për shqyrtimin e ankimit caktohen nga Komisioni në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 44/2015.

2. Në varësi të objektit të ankimit dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, Komisioni cakton një afat të arsyeshëm për përfundimin e procedurës administrative, i cili në çdo rast nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë nga data e njoftimit të Komisionit për pranimin e ankimit.

3. Zgjatja e afatit të procedurës administrative përtej kufiri të përcaktuar nga ligji nr. 44/2015 mund të bëhet nga Komisioni, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të



çështjes. Zgjatja e afatit nga Komisioni mund të bëhet vetëm një herë dhe bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.

4. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nën ligjore mund të zgjatet vetëm nëse parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga Komisioni mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.

Neni 26

Rivendosja në afat

1. Përveçse kur ndalohet shprehimisht me ligj, palët e njoftuara nga Komisioni për fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e ankimit mund të kërkojë rivendosjen në afat, nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afatit procedural, me përjashtim të rastit kur afatet kanë karakter prekluziv.

2. Rivendosja në afat mund të kërkohet:

- a) në lidhje me afatet për kryerjen e veprimeve gjatë procedurës administrative; si dhe
- b) çdo afat tjetër në dëm të palëve.

3. Kërkesa për rivendosjen në afat bëhet brenda 15 ditëve nga dita kur janë eliminuar pengesat, por jo më vonë se 1 vit nga data e përfundimit të afatit të humbur. Në të njëjtin afat do të kryhet edhe veprimi procedural, për të cilin pala ka humbur afatin për shkaqe të arsyeshme.

Neni 27

Vendimi dhe pasojat e rivendosjes në afat

1. Komisioni shqyrton kërkesën e paraqitur nga pala në procedurën administrative për rivendosjen në afat dhe merr vendim brenda 15 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës përpara tij.

2. Depozitimi i kërkesës shkakton pezullimin e të gjitha veprimeve procedurale të kryera si pasojë e humbjes së afatit.

3. Kundër vendimit të Komisionit për mospranimin e kërkesës për rivendosjen në afat, mund të bëhet ankim sipas rregullave të parashikuara nga ligji nr. 44/2015.

4. Pranimi i kërkesës për rivendosjen në afat shkakton anulimin e të gjitha veprimeve procedurale, të kryera si pasojë e humbjes së afatit.

Neni 28

Hetimi administrativ

1. Komisioni nëse gjatë procedurës administrative për shqyrtimin e ankimit gjykon për nevojën e kryerjes së një hetimi administrativ zhvillon procedurën hetimore në përputhje me parashikimet ligjore për këtë qëllim të përcaktuara në ligjin nr. 44/2015.

2. Veprimet administrative për kryerjen e hetimit administrativ kryhen nga struktura përgjegjëse në ERRU sipas organikës.

Neni 29

Pasojat juridike të vendimit përfundimtar

1. Vendimi përfundimtar si akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin palëve të përmbajtjes së aktit.

2. Data e fillimit të pasojave juridike të aktit administrativ vendimmarrës caktohet shprehimisht në pjesën e dispozitivit të aktit administrativ të shkruar.

3. Kundër aktit administrativ vendimmarrës përfundimtar mund të paraqitet ankim administrativ në përputhje me përcaktimet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 44/2015.

Neni 30

Ekzekutimi i aktit administrativ vendimmarrës

Ekzekutimi i aktit administrativ vendimmarrës në përfundim të procedurës administrative për shqyrtimin e ankimit kryhet në përputhje me përcaktimet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 44/2015.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDMENeni 31
Çështjet e pa rregulluara

Çështjet e pa rregulluara nëpërmjet kësaj rregullore lidhur me procedurën administrative për shqyrtimin e ankimit zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në përputhje me përcaktimet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 44/2015.

Neni 32
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi datën e miratimit të saj nga Komisioni.

VENDIM
Nr. 19, datë 19.4.2019**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 6, DATË 3.2.2017,
“PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME GJIROKASTËR”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”(VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 19.4.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. (UK Gjirokastër) për ndryshim të licencës për shkak të ndryshimit të drejtuesit teknik”,

VËREN SE:

1. Shoqëria UK Gjirokastër me shkresën nr. 142 prot., datë 12.2.2019, me lëndë “Dërgojmë të dhënat mbi ndryshimin e drejtuesit teknik” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe rregullores së licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Gjirokastër për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Gjirokastër sh.a. plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi profilin e edukimit.

4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) ERRU-ja ka licencuar shoqërinë UK Gjirokastër me vendimin nr. 6, datë 3.2.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura;

b) ERRU-ja, me vendimin nr. 52, datë 6.7.2018, “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 6, datë 3.2.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Gjirokastër”, i ndryshuar, ka rinovuar licencën e UK Gjirokastër me drejtuesin ligjor z. Dhimitri Kristidhi.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Gjirokastër sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.



Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Gjrokastër është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit të KKRR-së nr. 6, datë 3.2.2017, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Gjrokastër”, i ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

“Drejtues teknik Bashkim Tola”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Ndriçim Shani**

**VENDIM
Nr. 20, datë 19.4.2019**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR
MIRATIMIN E TARIFAVE TË
SHËRBIMIT TË LARGIMIT TË
UJËRAVE TË NDOTURA PËR
SHOQËRINË UJËSJETLLËS-
KANALIZIME MALËSI E MADHE**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015 “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015 “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Faqe | 5308

Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e datës 19.4.2019 pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Miratimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për miratimin e tarifave të largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Malësi e Madhe”,

konstatoi se:

Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Malësi e Madhe është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) me vendimin nr. 51, datë 2.12.2016, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës Malësi e Madhe”, për kategorinë e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik.

Me vendimin nr. 78, datë 26.11.2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 51, datë 2.12.2016, “Për licencimin e sh.a. Ujësjetllës Malësi e Madhe”, i ndryshuar, shoqëria UK Malësi e Madhe u licencua nga KKRR-ja për ushtrimin e aktivitetit të largimit të ujërave të ndotura për Njësinë Administrative Koplik.

Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Malësi e Madhe, me shkresën nr. 75 prot. datë 18.2.2019, ka aplikuar pranë ERRU-së për miratimin e tarifave për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura.

Me anë të shkresës nr. 89 prot. datë 28.2.2019, “Dërgim dokumentacioni”, UK Malësi e Madhe plotësoi dosjen e aplikimit në përputhje me vendimin nr. 40.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Malësi e Madhe është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Malësi e Madhe për miratimin e tarifave për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Malësi e Madhe dhe Bashkinë Malësi e Madhe për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Ndriçim Shani**

**VENDIM****Nr. 21, datë 19.04.2019****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 44, DATË 14.10.2016
PËR “LICENCIMIN PËR HERË TË
PARË PËR SHA UJËSJELLËS-
KANALIZIME VORË”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr.958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 19.4.2019 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Vorë sh.a. (UK Vorë) për ndryshim të licencës për shkak të ndryshimit të drejtuesit teknik.”,

VËREN SE:

1. Shoqëria UK Vorë me shkresën nr. 289 prot., datë 26.3.2019, me lëndë “Kërkesë për ndryshim licence” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe rregullores së licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Vorë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. ERRU-ja ka licencuar shoqërinë UK Vorë me vendimin nr. 44, datë 14.10.2016 “Për licencimin për herë të parë për sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vorë” (vendimi i KKRR-së nr. 44), me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtuesi teknik i shoqërisë UK Vorë sh.a. plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi profilin e edukimit.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vorë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Vorë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 44, datë 14.10.2016 “Për licencimin për herë të parë për sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Vorë”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

“Drejtues teknik: Majlinda Bylykbashi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Ndriçim Shani**

KËRKESË

Shtetasi Adem Tata, i datëlindjes 4.4.1942, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, shpalljen të vdekur të djalit të tij, shtetasit Haxhi Tata i datëlindjes 30.10.1981.

**KËRKUES
Adem Tata**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë